



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 94, paragrafit (1), pikës 37, të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 178/2021), si dhe të nenit 85, paragrafit (1), pikës 37, të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE
për mënyrën e kontrollimit të njohurive të studentëve
në Universitetin e Tetovës

Neni 1

Kontrollimi i njohurive të studentëve të Universitetit të Tetovës (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti), për lëndët mësimore, realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit mësimor-arsimor dhe shprehet me pikë.

Neni 2

Kontrollimi i njohurive në lëndë të veçanta mësimore realizohet sipas mënyrës së përcaktuar nga mësimdhënësi i lëndës, e cila përfshihet në programin studimor dhe zbatohet brenda afateve të përcaktuara me Statutin e Universitetit.

Neni 3

Me mënyrat e mundshme të kontrollimit të njohurive të studentit nënkuptohet mbledhja dhe interpretimi i të dhënave lidhur me suksesin e arritur nga studenti ose studentët, përkatësisht me shkallën e përvetësimit të përmbajtjes së lëndëve mësimore të parashikuara në programin studimor.

Kontrollimi i njohurive të studentit, përkatësisht vlerësimi, realizohet nëpërmjet shqyrtimit të detyrave të vazhdueshme dhe detyrave të shtëpisë/projekteve, kolokuiumeve, punimeve seminarike, vijueshmërisë në ligjërata dhe ushtrime, si dhe provimit përfundimtar.

Neni 4

Vlerësimi i aktiviteteve të përgjithshme shprehet në përqindje.

Numri i përgjithshëm i përqindjeve për kontrollimin e njohurive të studentit është 100%.

Përqindjet mblidhen gjatë vlerësimit të aktiviteteve të studentit për detyrimet e caktuara në kuadër të lëndës.

Në planprogramin e secilës lëndë përcaktohet shpërndarja e përqindjeve, si vijon:



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

1. për kontrollimin e njohurive nëpërmjet një testi ose dy kolokuiumeve;
2. përqindja nga testi me shkrim;
3. përqindja nga testi me gojë (nëse realizohet);
4. përqindja për vijueshmërinë në ligjërata dhe ushtrime;
5. përqindja për praktikën (nëse realizohet);
6. përqindja nga aktivitetet/puna individuale;
7. përqindja nga detyra seminarike/projektuese.

Neni 5

Shuma e përqindjeve për të gjitha aktivitetet që do të përcaktohen në programin e lëndës nuk duhet të tejkalojë 100%.

Mësimdhënësi ka të drejtë të përcaktojë edhe kriterin për përmbushjen me sukses të të gjitha kriterëve të përcaktuara në programin e lëndës.

Secili aktivitet i studentit, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, duhet të realizohet në masën mbi 50% të përqindjes së parashikuar për atë aktivitet.

Neni 6

Në fillim të secilës lëndë, studentët duhet të informohen detyrimisht për plan-programin, mënyrën e vlerësimit dhe kriteret që do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e pikëve dhe të notës përfundimtare në lëndën përkatëse; përkatësisht, 51% e numrit të përgjithshëm të përqindjeve nga të gjitha aktivitetet rezulton me notën gjashtë, ndërsa përqindjet pasuese me notat deri në 10.

Neni 7

Për përmbushjen e detyrimeve lidhur me dhënien e provimit (pjesërisht ose në tërësi), studenti vlerësohet me notë numerike nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë), ku nota 5 (pesë) nënkupton sukses të pamjaftueshëm.

Vlerësimi përfundimtar shënohet detyrimisht në fletëparaqitjen dhe raportin e provimit, në indeks dhe/ose në sistemin elektronik, nëse ky i fundit është funksional.

Vërtetimi ose dokumenti për vlerësimin përfundimtar lëshohet në bazë të të dhënave në fletëparaqitjen e provimit për secilën lëndë, të nënshkruar nga mësimdhënësi i lëndës.

Neni 7-a

Përpara përmbylljes së vlerësimit përfundimtar, mësimdhënësi i lëndës cakton detyrimisht konsultime.

Vlerësimi përfundimtar përmbyllet jo më herët se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë pas mbajtjes së konsultimeve.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Neni 8

Suksesi mesatar i studentit përbën mesataren aritmetike të notave nga vlerësimi përfundimtar në të gjitha lëndët mësimore gjatë studimeve në programin studimor, duke përfshirë edhe provimin përfundimtar, nëse ai parashikohet në programin studimor.

Neni 9

Provimi në një lëndë mësimore mund të jepet më së shumti tri herë; herën e katërt, me kërkesë të studentit, provimi zhvillohet para një komisioni të përbërë nga tre mësimdhënës të së njëjtës fushë mësimore ose të një fushe të përafërt.

Komisionin nga paragrafi paraprak i këtij neni e formon dekani i njësisë.

Mësimdhënësi tek i cili studenti e ka dhënë provimin nuk mund të jetë anëtar i komisionit nga paragrafi i parë i këtij neni.

Neni 10

Brenda 24 orëve nga publikimi i rezultateve të vlerësimit përfundimtar, studenti mund ta pranojë ose të mos e pranojë notën.

Nëse studenti nuk e pranon notën, ai ka të drejtë t'i paraqesë kundërshtim dekanit të njësisë së Universitetit, kur nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, përkatësisht me notën, ose kur vlerëson se provimi nuk është zhvilluar në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e Universitetit dhe të njësisë.

Provimi në një lëndë mësimore mund të jepet më së shumti tri herë në afatet e rregullta të provimeve, gjatë një viti akademik.

Studenti mund ta japë provimin edhe për herë të katërt, nëse me vendim të Këshillit të Rektoratit është përcaktuar një afat shtesë provimesh gjatë vitit akademik përkatës.

Mësimdhënësi tek i cili studenti e jep provimin nuk mund të jetë anëtar i komisionit.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Kryetari i Senatit

Prof. Dr. Vullnet Ameti